



Kanton Bern  
Canton de Berne

**hallo-bern.ch**  
**salut-berne.ch**

# Gjuha dhe integrimi

Integrimi

Ofertat për integrim

Gjuha

Me mësue gjermanisht ose frëngjisht

**hallo-bern.ch**

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri  
Gjuha dhe integrimi



# Integrimi

Prej huajave dhe të huajve pritet, që të integrohen në shoqëri. Kjo do të thotë me ju përmbajt ligjeve, ekonomikisht me u përkujdes vetë për vetën dhe me mësuë gjermanisht.

## Parimet themelore më të rëndësishme

Të gjitha banoret dhe banorët në Zvicër duhet t`i përmbahen kushtetutes shtetërore (p.sh. barazia burr/grua) dhe t`iu përmbahen ligjeve ekzistuese. Pëveç kësaj pritet, që ekonomikisht njeriu të përkujdeset vetë për vetën, derisa është e mundshme. Prej të huajave dhe të huajve kërkohet, që sa më shpejt që të jetë e mundshme ta mësojnë gjuhën e vendbanimit. Mirëpo integrimi mund të bëhet vetëm nëse të dy palët japin kontribut. Për këtë pritet prej popullatës vendore hapje kundrejt të huajave dhe të huajve.

## Përgjegjësia individuale

Shteti, kantonet dhe komunat përkujdesën për atë, që të huajat dhe të huajt ta kenë të drejtën e hyrjes në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Të huajat dhe të huajt duhet nga ana e tyre me përgjegjësi individuale të mundohen që të integrohen. Njeru pret prej tyre që ofertat e përgatitura të shfrytëzohen.

## Pjesëmarrja në jetën shoqërore

Një mundësi të mirë për tu integruar në shoqërin zvicërore dhe për të njohur njerëz janë shoqatat. Mirëpo edhe festat dhe organizimet në komuna janë të përshtatshme me lidh kontakte. Ngritja mundet me qenë paksa e vështirë, jo të gjitha banoret dhe banorët në Zvicër janë njësoj të hapur kundrejt kulturave të huaja. Nganjëherë nevojitet paksa durim.

## Njoftime / mbështetje

Në kantonin e Bernit për të posa ardhurit ka në dispozicion zyra të ndryshme të kontaktit. Vendi i parë i mirë për tu njoftuar është komuna. Mirëpo ka edhe pika të tjera specifike për emigrante dhe emigrant. Në kantonin e Bernit ka shumë zyra rajonale për integrim (Anspruchstellen Integration | antennes d'intégration). Këto informojnë për jetën në Zvicër dhe ju përgjigjen pyetjeve konkrete për tema të ndryshme. Kush nuk flet ende gjermanisht apo frëngjisht, mundet me e sjell dikend të përkthaj apo të lus për një përkthyes apo përkthyes. Disa zyra kontakti informojnë edhe në gjuhë të tjera.



Kanton Bern  
Canton de Berne

**hallo-bern.ch**  
**salut-berne.ch**

**Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-bern.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/integrimi](http://www.hallo-bern.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/integrimi)

**hallo-bern.ch**

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri  
Gjuha dhe integrimi



## Ofertat për integrim

Integrimi bëhet para s`gjithash në shkollë dhe punë. Për personat, që (ende) nuk kanë çasje në këto fusha, ka oferta të ndryshme për integrim.

### Ofertat specifike

Ka oferta specifike të shumta për të huajat dhe të huajt, të cilat ndihmojnë me u ambientuar në shoqërin zvicerane dhe me ndërlidhë kontakte. Ka ndër të tjera biseda në rreth, oferta për kohë të lirë, referate dhe kurse. Zyra kontaktuese për Integrim (AI) (Anspruchstellen Integration | antennes d'intégration) apo komuna ku banoni informojnë për ofertat. Shumë komuna e organizojnë një takim, për me i përshëndet banoret dhe banorët e rinj-një mundësi e mirë, për ta krijuar një pamje të përgjithshme.

### Shoqatat

Shumë banore dhe banorë të kantonit të Bernit janë anëtarë në një shoqatë (Verein | Association). Ka shumë shoqata për interesa të ndryshme. Edhe në komuna të vogla ekzistojnë shoqata për sport-, kulturë dhe të tjera. Ato ofrojnë mundësi ideale për me ra në kontakt me njerëzit e tjerë. Shumica e shoqatave janë për të gjithë personat të hapura. Informacione për shoqata, gjinden edhe në faqet e internetit të komunave.

### Organizatat e emigrantëve

Sipas gjuhës, vendit të ardhjes apo besimit, ka shoqata të ndryshme, në të cilat emigrantet dhe emigrantët organizohen vetë. Shpesh ofrojnë këto shoqata oferta për integrim dhe këshillim, për me i mbështet antarët e tyre pas ardhjes në Zvicër dhe në kantonin e Bernit.

### Ofertat për të rinjë

Për të rinjët ka në kantonin e Bernit shumë oferta specifike, për ta kaluar kohën e lirë dhe me njoftë bashkëmohatar. Në shumë komuna ka pikëtakime dhe oferta të ndryshme për ta kaluar kohën e lirë. Të rinjë janë nën përkujdesje, munden me i sjell idetët dhe me i zbatue projektet e tyre (Jugendarbeit | Animation de jeunesse). Ofertat janë zakonisht falas. Shoqatat për të rinjë e ofrojnë mundësin, që s`bashku me bashkëmohatar të ndërmarrin aktivitete dhe të ushtrojnë sport në natyrë. Bartës të ofertave janë shoqatat, komunat apo kishat e vendit. Ofertat janë të hapura për të gjithë të rinjët. Komuna jep njoftime të tjera.



Kanton Bern  
Canton de Berne

**hallo-bern.ch**  
**salut-berne.ch**

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-bern.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/ofertat-per-integrim](http://www.hallo-bern.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/ofertat-per-integrim)

**hallo-bern.ch**

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri  
Gjuha dhe integrimi



## Gjuha

Prej banoreve dhe banorëve që nuk e flasin gjuhën gjermane apo frënge, pritet në kantonin e Bernit, që ta mësojnë gjuhën gjermane apo frënge. Njohurit e gjuhës janë parakushti kryesor, për integrim në shoqëri dhe tregun e punës.

### Gjuhët zyrtare

Zvicra ka katër gjuhë zyrtare: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retroromanisht. Në kantonin e Bernit ka dy gjuhë zyrtare.

### Gjuha letrare gjermane / gjermanishtja zvicerane

Gjuhën gjermane në Zvicër e dallon njeriu gjuhën letrare gjermane (Hochdeutsch | l'allemand standard) dhe gjermanishten zvicerane (Schweizerdeutsch | le suisse allemand). Në shkollë dhe pjesërisht edhe radio dhe televizion flitet gjuha letrare gjermane. Po ashtu shkruhet në gjuhën letrare gjermane. Në përditshmëri flet njeriu gjermanishtën zvicerane. Kjo ka të bëjë me një dialekt të gjermanëve, që edhe për personat me njohuri të mira të gjuhës gjermane, nuk është gjithnjë lehtë të kuptohet. Nuk pritet, që të huajat dhe të huajt të flasin gjuhën gjermane zvicerane, mirëpo që pas një kohe në një masë të kuptohet. Njeriu mundet t`i lus zviceranet dhe zvicranët të flasin gjuhën letrare gjermane.

### Gjermanishtja dhe fëmijët

Preferohet, që fëmijët me gjuhë tjetër sa më herët që është e mundshme të bien në kontakt me fëmijë që flasin gjuhën gjermane apo frënge. Për këtë janë ideale grupet për lojë apo oferta speciale për prindër dhe fëmijë. Prindërit munden fëmijët e tyre t`i mbështesin edhe në atë që të flasin shumë me ta, t`i dëgjojnë dhe tu tregojnë përralla. Ata duhet ta bëjnë këtë në gjuhë që e zotrojnë më s`miri.

### Përkthimet

Nuk mund të pritet, që dikush direkt pas ardhjes të kuptoj dhe të flas mirë gjermanisht apo frëngjisht. Mirëpo ka situata, në të cilat njeriu duhet të kuptohet. Shumë të ardhur të rinjë i lusin të afërmit apo të njohurit për të përkthyer. Në biseda të komplikua, personale dhe të besueshme dëshiron njeriu ndoshta ta ketë një përkthyes apo përkthyes profesional. Përkthyeset dhe përkthyesit ndërkulturor janë të specializuar, dhe kanë konsideratë gjatë përkthimit për të veçantat kulturore. Te të kuptuarit dhe të shkruarit të letrave dhe në plotësimin të formularëve, ofrojnë ndihmë shërbime të ndryshme për shkresa (Schreibdienst | le service de correspondance) në kantonin e Bernit.



Kanton Bern  
Canton de Berne

**hallo-bern.ch**  
**salut-berne.ch**

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-bern.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/gjuha](http://www.hallo-bern.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/gjuha)

**hallo-bern.ch**

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri  
Gjuha dhe integrimi



# Me mësue gjermanisht ose frëngjisht

Me mësue saktë gjermanisht apo frëngjisht, preferohet shkuarja në një kurs të gjuhës. Oferta për kurse në kantonin e Bernit është e gjerë dhe e orientuar për situata të ndryshme jetësore.

## Ofertat

Shumë ofertues udhëheqin në kantonin e Bernit kurse të gjuhës për grupe të ndryshme. Disa ofertues janë ndërmarrje komerciale, tjerët janë me interes të përgjithshëm apo institucione shtetërore. Kush nuk e zotëron alfabetin latin apo ka vështërsi me shkrim e lexim, mundet me e vizitue një kurs për me e mësue alfabetin (Alphabetisierungskurs | Cours d'alphabétisation). Para se me e bërë një kurs të gjuhës njeriu duhet të informohet për llojet e ndryshme të kurseve dhe shpenzimet. Për nënat me fëmijët e tyre ka në shumë komuna kurse speciale, që i mbështesin në aspektin gjuhësor si nënat po ashtu edhe fëmijët (MuKi-Deutsch | Cours de français mère-enfant). Zyra kontaktuese rajonale për Integrim (AI) (Ansprechstellen Integration | antennes d'intégration) apo komuna ku banoni informojnë për ofertat.

## Nivelet gjuhësore

Si masë e matjes të njohurive gjuhësore në gjermanisht dhe frëngjisht shërben shpesh "Kornizë referimi e përbashkët evropiane" (GER). Gjashtë nivelet të ndërtuara të gjuhës janë prej nisjes A1 (nisja) deri C2 (njohuri të shkëlqyeshme). Shumica e kurseve të gjuhëve janë të orientuara në të gjitha këto nivele. Niveli A1 dhe A2 përputhen me njohurit bazë të gjuhës gjermane apo frënge. Kush pretendon të arsimohet në një profesion, duhet në shumicën e rasteve ta zotëroj nivelin B1 apo B2. Niveli C1 dhe C2, janë parakusht për studime në universitet.

## Njohurit gjuhësore

Gjuhëfolësit e huaj të ardhur duhet për nënshtetësi, për zgjatjen e leje qëndrimit- apo për qëndrim në Zvicër si dhe për ta sjell familjen të kenë njohuri në një nga gjuhët vendore.

## Finanzimi

Kurset e gjuhëve zakonisht duhet të paguhen vet. Çmimet janë të ndryshme dhe e vlen të krahasohen ofertat (çmimi për një njësi mësimore). Disa kurse mbështeten financiarisht prej kantonit të Bernit apo komunave dhe për pjesëmarrësit janë më lirë.





Kanton Bern  
Canton de Berne

**hallo-bern.ch**  
**salut-berne.ch**

**Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-bern.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/me-mesue-gjermanisht-ose-frengjisht](http://www.hallo-bern.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/me-mesue-gjermanisht-ose-frengjisht)

**hallo-bern.ch**

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri  
Gjuha dhe integrimi